NJOFTIM PUNËSIMI	
Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë.Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vend pune:**Protokolluese pranë Sektorit Protokoll/Arkivë në Drejtorinë Juridike**.Punëmarrësi Organizon punën e protokollit për evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve.
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	• Regjistron korrespondencën zyrtare, e përpunon dhe e shpërndan atë. • Organizon punën për evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve në bazë të Ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivin" dhe Ligjin 8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror", dhe "Normave tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" • Protokollon vendimet dhe urdhrat e Administratorit të Shoqërisë, si dhe praktikën shkresore të Shoqërisë të nënshkruar nga Administratori apo persona të tjerë të autorizuar prej tij Protokollon dokumentet që hyjnë dhe dalin nga Shoqëria, si dhe dokumentet ndërmjet sektorëve të Shoqërisë. • Përgjigjet për rregullsinë e regjistrimit të dokumentacionit në librat e protokollit. • Kryen përpunimin e dokumenteve në fund të vitit. • Bën njehsimin e dokumenteve me origjinalin, duke i sigluar ato në çdo faqe. • Ndjek përdorimin korrekt të vulës dhe përgjigjet për sigurimin e saj në bazë të Ligjeve.

	• Ka përgjegjësinë e plotë, për ruajtjen, mirë administrimin dhe sigurinë e vulës së Shoqërisë, sipas kërkesave të shprehura në rregullore. • Mban regjistër të mbledhjeve të Administratorit dhe i pasqyron mbledhjet në proces verbalin e mbledhjes
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	• Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Diplomës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.
• Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 23.10.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.	